REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I MINISTRAVE

## VENDIM (Draft)

**(Nr.______, datë_______2016)**

### PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË UJIT DHE TË SHKARKIMEVE TË LËNGËTA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 48, nenit 82, pikave 1 dhe 2, të nenit 92, të ligjit nr. 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", me propozim të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta, sipas tabelës nr.1, që është pjesë e këtij vendimi.

2. Detyrimet financiare sipas tarifave të tabelës nr. 1, derdhen në llogarinë bankare të Ministrisë përgjegjëse për ujërat dhe është e pakthyeshme. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë vendim derdhen në Buxhetin e Shtetit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për ujërat, Ministria e Financave dhe Agjencitë e Baseneve Ujore.

4. Vendimi nr. 23, datë 9.01.2008, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**M I N I S T R I**

**EDMOND PANARITI**

Tabela Nr.1

TARIFAT E PËRDORIMIT TË UJIT DHE TË SHKARKIMEVE TË LËNGËTA

| | **QËLLIMI I PËRDORIMIT TË UJIT** | **PËRDORUESIT** | **TARIFAT E SHKARKIMEVE TË LËNGËTA NË UJË** | **TARIFAT E PËRDORIMIT** | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Ujë sipërfaqësor** | **Ujë nëntokësor** |
| 1.0 | FUNIZIMI ME UJË | | | | |
| 1.1 | | Shoqëritë ujësjellës kanalizime, prodhim uji deri në 10 milion m3/vit | ------ | 0,05 (lek/m3) | 0,08(lek/m3) |
| 1.2 | | Shoqëritë ujësjellës kanalizime, prodhim uji deri në 20 milion m3/vit | ------ | 0,05(lek/m3) | 0.09(lek/m3) |
| 1.3 | | Shoqëritë ujësjellës kanalizime, prodhim uji mbi 20 milion m3/vit | ------ | 0,05 (lek/m3) | 0.1(lek/m3) |
| 1.4 | | Ujësjellës që furnizon nje ose disa fshatra | ------ | 0.01(lek/m3) | 0.03 (lek/m3) |
| 1.5 | | Familje që nuk lidhen me rrjetin e furnizimit me ujë të shoqerive ujësjellës kanalizimeve me të | ------ | ------ | 1.5 (lek/m3) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | afërta ose që duan të vetfurnizohen | | | |
| 1.6 | | Njësi tregëtare e industriale si: lavazhe, perpunim mermeri,etj. kur ato shfrytëzojnë drejtpërdrejtë ujëra sipërfaqësore ose një burim ujor nëntokësor | 4 (lek/m3) | 1.5 (lek/m3) | 4.5(lek/m3) |
| 1.7 | | Njësi tregëtare, të prodhimit të ujit mineral dhe natyral të amballazhuar, destinuar për pirje | ------- | 5(lek/m3) | 12.3 (lek/m3) |
| 1.8 | | Njësi tregëtare, e industrisë së prodhimit të pijeve alkolike dhe jo alkolike me pus individual, ose furnizim nga burimi | 2.8 (lek/m3) | 5(lek/m3) | 12.3 (lek/m3) |
| 1.9 | | Ndërmarje tregëtare, e industriale që përdorin ujin për proçes tekniko-teknologjik për përpunimin dhe qarkullimin e naftës dhe derivateve të naftës, për ftohjen e gazit natyror, metalurgjisë së zezë, metalurgjisë së ngjyrosur, Industrise minerare, industrisë së tekstilit, industrisë së letrës, lëkurës, | 5 (lek/m3) | 1.5 (lek/m3) | 2.5 (lek/m3) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | fermave, thertoreve dhe industrisë së mishit, serviseve të automjeteve dhe makinave | | | |
| 2.0 | PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE | | | | |
| 2.1 | | KESH | | 1% të çmimit të shitur për çdo kilovat-orë të prodhuar në hidrocentral | ------ |
| 2.2 | | Shoqëri private të prodhimit të energjisë, hidrocentrale | ------ | 2.3% të çmimit të shitur | ------ |
| 2.3 | | Termo elektro central me ftohje | ------ | 1.7% të çdo kilovat-orë të prodhuar në termocentrale t me sistem të mbyllur të ftohjes | ------ |
| 3.0 | PËR UJITJE NË BUJQËSI DHE BLEGTORI | | | | |
| 3.1 | Bujqësi | Ujitjen e tokave bujqësore nga liqene/rezervuar artificialë | 2,5 (lek/$m^3$) | 500 (lek/ha) | ------ |
| 3.2 | Bujqësi | Ujitje nga burime natyrore | 2.5(lek/m3) | 300 (lek/ha) | ------ |
| 3.3 | Blegtori | Ujë për qëllime blegtoriale | 4 (lek/m3) | 3 (lek/m3) | (4 lek/m3) |
| 4 | PËR AKUAKULTURË | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | Impiante kultivimi intensive peshku etj. | | 1.2<br><br>(lek/kg peshk i shitur) | 1<br><br>(lek/kg peshk i shitur) | 2<br><br>(lek/kg peshk i shitur) |
| 5.0 | UJËRA KURATIVE, TERMOMINERALE, MINERALE DHE GJEOTERMALE | Shoqëri private (llixhat) | 4.5 (lek/vaskë/muaj) | ------ | 8 (lek/vaskë) |
| 6.0 | TURISTIKE | | | | |
| 6.1 | Qëllime turistike | | ------- | ------ | 8 (lek/m3) |
| 6.2 | Përdorim i ujit për pishina | Shoqëri private | 20(lek/m3) | 40(lek/m3) | 80(lek/m3) |
| 7 | PËR SHFRYTËZIM MATERIALESH INERTE | | | | |
| 7.1 | Shfytëzim i materialeve inerte lumore | | ------ | 2% të vlerës së materialit të shitur | ------- |
| 7.2 | Shfytëzim i materialit rërë lumi | | ------ | 2% të vlerës së materialit të shitur | -------- |